

URDHËR
Nr. 386, datë 29.7.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të nenit 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; ligjit nr. 111/2017, “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”; si dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 21, datë 1.3.2023, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z. Ergys Qirici, te drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për periudhën 5 gusht 2024–18 gusht 2024.
 2. Kompetencat e deleguara të titullarit do të ushtrohen përgjatë periudhës së pamundësisë së ardhjes në punë të drejtorit të përgjithshëm si rezultat i kryerjes së lejes vjetore.
 3. Në kompetencat e deleguara nuk përfshihen kompetencat e nëpunësit autorizues të institucionit për veprimet pranë Degës së Thesarit Tiranë.
 4. Ngarkohet znj. Lefkothea Lite për zbatimin e këtij urdhri, Arkiv-Protokolli për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.
- Ky urdhër hyn në fuqi më datë 5.8.2024 dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ergys Qirici